




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of South Mitrovica



PLANI I PUNËS

2026



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore

Opština Juzna Mitrovica – Municipality of South Mitrovica

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturë

Drejtori

Naser Muja



Tabela e Përmbajtjes

PLANI I PUNËS	1
1. HYRJE.....	4
2. QËLLIMI STRATEGJIK DHE PLANIFIKIMI.....	4
3. OBJEKTIVAT KRYESORE PËR 2026	5
4. PËRGJEGJËSIT E DSHPI-së	6
5. ORGANIZIMI I DSHPI-së.....	6
6. AKTIVITETET DHE KONTRATAT E PLANIFIKUARA NË PROKURIM.....	6
7. MONITORIMI DHE ZBATIMI.....	7
8. PËRFUNDIM.....	7

1. HYRJE

Plani i Punës për vitin 2026 i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës (DSHPI) është hartuar në përputhje me Statutin Komunal, Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe buxhetin e miratuar për vitin 2026.

Ky plan përcakton objektivat strategjike, aktivitetet prioritare, kontratat e planifikuara në prokurim si dhe mekanizmat e monitorimit dhe zbatimit, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës dhe përmirësimin e shërbimeve publike për qytetarët.

2. QËLLIMI STRATEGJIK DHE PLANIFIKIMI

Zhvillimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore dhe publike, përmirësimi i shërbimeve publike dhe ngritja e cilësisë së jetës për qytetarët përmes investimeve kapitale dhe mirëmbajtjes sistematike.

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës ka ushtruar veprimtarinë konform detyrimeve dhe përgjegjësi që përcakton Statuti Komunal në realizimin e projekteve në disa rrafsh komplekse dhe shumëdimensionale, me theks të veçantë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, duke intervenuar optimalisht konform pozicioneve të përcaktuara sipas buxhetit komunal. Hartimi i planeve e projekteve konkrete afatshkurtra dhe afatmesme duke përpiluar edhe Rregullore dhe Vendime adekuate të kësaj natyre, duke ofruar shërbime efektive dhe profesionale gjithnjë në të mirë të Komunës dhe qytetarëve të sajë ka qenë dhe mbetet objektivi parësor.

Prioritetet e përcaktuara nga kjo për vitin 2026:

- Ndërtimi i rrugëve lokale e regjionale
- Ndërtimi i rrugëve lokale me kubëza betoni me participim me qytetarët
- Ndriçimi publik
- Shenjëzimi horizontal, vertikal e sinjalizues Autoparkingjet
- Ndërtimi i trotuareve, Shesheve dhe hapësirave të ngjashme
- Dhënia e hapësirave publike me qira apo me koncesion
- Licencimi i auto-taxive të qytetit
- Shërbime profesionale, inspektime, mbikëqyrje, pranime teknike,
- Aktvendime, procedura kundërvajtës, procesverbale etj.

- Zbatimi dhe monitorimi i projekteve të ndryshme ndërtimore në lëmin e infrastrukturës ;
- Zbatimi dhe monitorimi i projekteve të ndryshme të angazhuara nga drejtorit tjera në nivel Komunal
- Përgatitja e lëndëve të drejtorive përkatëse në të cilat ka nevojë për inxhinieri ndërtimore;
- Pjesëmarrja në hapjen e tenderëve si dhe klasifikimin e ofertueseve;
- Krijimi-ndërtimi i hapësirave të reja të gjelbërta

3. OBJEKTIVAT KRYESORE PËR 2026

Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në qytete dhe në fshatra:

Asfaltimi i rrugëve lokale,

Kubëzimi i rrugëve,

Ndërtimi i trotuareve,

Riparimi i rrugëve dhe

Ndërtimi i rrugëve me zhavor.

Përmirësimi i gjendjes së furnizimit me ujë të qytetarëve dhe gjendja e kanalizimeve

Ndërtimi i rrjeteve të reja të kanalizimit të ujërave të zeza dhe

Riparimi(debllokimi) i rrjeteve të kanalizimeve atmosferike dhe fekale.

Përmirësimi i fondit të sipërfaqeve të gjelbruara

Ndërtimi i shesheve

Ndërtimi i parqeve

Ngritja e sipërfaqeve të gjelbruara.

Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik dhe sinjalizimi

Përmirësimi i gjendjes së sinjalizimit horizontal dhe vertikal

Rregullimi i trafikut dhe transporti publik

Përmirësimi i shërbimeve komunale

Mirëmbajtja verore dhe dimrore e rrugëve

Krijimin e parkingjeve Publike

4. PËRGJEGJËSIT E DSHPI-së

Përgjegjësia e DSHPI-së është shumë komplekse e cila kërkon staf të mjaftueshëm, eksperiencë të duhur në fushë veprimin e angazhuar dhe më gjerë, mirë të kualifikuar i cili në rastin tonë mund të thuhet se është i mjaftueshëm , ai madj kemi deficit në çdo aspekt e sidomos në aspektin inxhinierik për infrastrukturë.

Nuk është e tepërt të thuhet se stafin e këtij departamenti duhet ta karakterizojnë njohurit shumë dimensionale e specifike, të cilat janë mase të domosdoshme, për përmbylljen me sukses të proceseve të përcaktuara nëpër të cilat ka kaluar dhe po kalon DSHPI.

5. ORGANIZIMI I DSHPI-së

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, aktivitetet i filloi duke u bazuar në program të punës, në buxhetin komunal dhe objektivat e qeverisë komunale për vitin 2026, si dhe vazhdimin e punëve të planifikuara nga viti i kaluar.

DSHPI përbëhet nga dy sektorë:

Spektori i Shërbimeve Publike dhe

Spektori i Infrastrukturës.

6. AKTIVITETET DHE KONTRATAT E PLANIFIKUARA NË PROKURIM

I. KONTRATA PËR FURNIZIM

Aktivitetet:

Furnizim me mobilje për zyre

Furnizim me material ë përgjithshme për zyre

II. KONTRATA PËR SHËRBIME

Aktivitetet:

- Mirëmbajtja e hapësirave publike
- Hartimi dhe mbikqyrja e projekteve kapitale
- Siguria në Komunikacion
- Mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik

- Mirëmbajtja e varrezave dhe lapidarëve
- Furnizimi, mirëmbajtja e paisjeve sinjalizuese ndriquese në komunikacion

III. KONTRATA PËR PUNË (INVESTIMET KAPITALE)

Aktivitetet:

- Asfaltimi dhe rregullimi i rrugëve në Vllahi, Melenice, Bajgore, Stan Terg, 2 Korriku, Shupkofc, Vinarc, Bair, Ilirid dhe Qender
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Bajgore
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Koshtovë
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Vllahi
- Zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik në Shale të Bajgore, Koshtovë, Broboniq, Zhabar, Ilirid, Shipol, Qender, Bair, Ilirid, Suhodoll
- Ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe fshatra
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Terrstenë
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Rashan
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Kollevhtë
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Kutlllofc
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Frashër
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Verrnice dhe Pirrq
- Ndërtimi i rrugëve në fshatrat Kaqandoll, Vidishiq, Maxher, Ofqar, Rahove, Dedi

7. MONITORIMI DHE ZBATIMI

- Mbikqyrje teknike e projekteve
- Raporte mujore të aktiviteteve
- Kontrolli i cilësisë së punimeve
- Koordinim me Zyrën e Prokurimit
- Raportimi periodik në Kuvendin Komunal

8. PËRFUNDIM

Plani i Punës për vitin 2026 paraqet një dokument strategjik dhe operacional që synon zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës komunale dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve publike. Zbatimi i suksesshëm i tij kërkon angazhim profesional, menaxhim efikas dhe monitorim të vazhdueshëm.